

Kompania Rajonale e Mbeturinave Regionale Kompanija za Uklanjanje Otpada "PASTRIMI" SH.A. i.d.d.	
Nr. 021011182	Shtojcë
Dt. 26.03.2026	
Prishtinë-Prishtinë	



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE (KRM) "PASTRIMI" SH.A

PËR/ZA/TO:		Z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit; Z. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit Komunal të Lipjanit; Aksionarët e KRM "Pastrimi" SH.A., Komuna e Lipjanit; Z. Adrian Rashiti, Anëtar/përfaqësues i Bordit të Drejtorëve të KRM "Pastrimi" SH.A Komuna e Lipjanit.			
NGA/OD/FROM:		Petrir Reçica, Kryeshef Ekzekutiv në KRM "Pastrimi" Sh.A – Prishtinë			
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		Raporti Financiar për Njësinë Operative të Lipjanit për vitin 2025			
Nr. i zyrës:	Zyra e	Lokacioni:	Rr. "Tahir Zajmi"	Data:	26.03.2026
Br. kancelarije:	Kryeshefit	Kucni:	Prishtinë	Datum:	
Room No.:	Ekzekutiv	Extension:		Date:	

Të nderuar;

Ju lutem gjeni të bashkëngjitur Raporti Financiar për Njësinë Operative të Lipjanit për vitin 2025 dhe një përshkrim të shkurtër financiar të KRM "Pastrimi" Sh.A. në përgjithësi së bashku edhe me tabelën e detajuar financiare të njësisë.

Ju faleminderit!

Kompania Rajonale e Mbeturinave
Regionale - Kompanija za Uklonjanje Otpada
"PASTRIMI" SH.A./d.d.
Nr. 021011182 Shtojcë
Dt. 26.03.2026 10
Prishtinë-Prishtina



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE
"PASTRIMI" SH.A.

Raporti financiar i Njesisë Operative të Lipjanit për vitin 01 Janar – 31 Dhjetor 2025

Mars 2026

1. PËRMBLEDHJE

Ky raport paraqet performancën financiare dhe operacionale të Njesisë Operative- Lipjan për periudhën 01 janar – 31 dhjetor 2025 në veçanti, dhe një përmbledhje të përgjithshme të ndërmarrjes në kuptim të organizimit financiar-operativ. Raporti synon të informojë aksionarin – Komunën e Lipjanit – mbi të ardhurat, shpenzimet, sfidat dhe masat e nevojshme për të përmirësuar qëndrueshmërinë financiare të njësisë.

Në organizimin e ndërmarrjes, Njësia Operative e Lipjanit si pjesë përbërëse e KRM “Pastrimi” Sh.A. funksionon dhe vepron në shërbim të qytetit të Lipjanit. Në bazë të organogramit sipas Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në KRM “Pastrimi” Sh.A., Njësia Operative e Lipjanit ka pësuar ndryshime organizative dhe të cilat në një formë do të mundësojnë qasjen më të lehtë në kryerjen e punëve ditore përmes mundësive që janë përcaktuar përmes pozitave të reja të cilat kanë qenë të nevojshme, sidomos në sistemin financiar dhe atë operativ. Sipas këtyre ndryshimeve struktura organizative e njësisë përbëhet nga: Menaxheri i njësisë, përgjegjësi operativ i njësisë, mbikëqyrësi i grumbullimit të mbeturinave, mbikëqyrësi i mirëmbajtjes së hapësirave dhe higjienes publike, Kryepunëtorët, Mekaniku, Axhustatori, salduesi, shoferët, kontrollat interne e njësisë, asistenti administrativ, punëtorët e bartjes dhe higjienës, punëtori i sigurimit/roje, mbikëqyrësi financiar, zyrtari për shpenzime - pagesa, inkasantët, arkatarët në portoarkë dhe depoisti. Aktualisht njësia në nivelin funksional të resurseve humane ka gjithsej 56 punëtorë me kontratë të rregulltë.

Ndryshimet në bazë të rregullores së re për sistematizimin janë bërë me qëllim që të lehtësohet puna në njësi sidomos në aspektin operativ duke u paraparë pozitave në mekanik që kanë të bëjnë me rregullimet e kamionëve në mënyrë që për parashikim të cilat nuk janë të ndërlikuara apo të natyrës më të rëndë të mos kenë nevojë që të dërgohen në autoparkun qëndror në Prishtinë e cila rezulton edhe me humbje në kohë e sigurisht edhe kosto më të lartë të shpenzimeve të bartjes. Gjithashtu është përcaktuar edhe njësia e financave dhe pagesave të cilat në të kaluarën nuk kanë qenë, dhe të njëjtat është menduar që të lehtësohen punët në kuptim të organizimit financiar, barazimeve financiare dhe pagesave. Ideja bazike e këtyre përcaktimeve kanë qenë që t’i paraprihet procesit të filluar të Decentralizimit të kostove financiare.

FJALA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

Viti 2025 ka qenë një ndër vitet më sfiduese për Ndërmarrjen tonë, i karakterizuar nga angazhim i lartë operacional, por edhe nga një situatë e rënduar financiare, e cila ka ndikuar drejtpërdrejt në funksionimin e përditshëm të ndërmarrjes.

Sfida kryesore gjatë këtij viti ka qenë raporti financiar me Komunën e Prishtinës, si aksionari ynë kryesor. Mospagesat e zgjatura kanë krijuar një presion të vazhdueshëm financiar, duke reflektuar në pamundësi për përmbushjen me kohë të obligimeve ndaj operatorëve të deponisë, furnizimit me naftë, si dhe ndaj shpenzimeve të tjera operative, të cilat janë jetike për ofrimin e shërbimeve bazike.

Si pasojë e kësaj situatë, ndërmarrja është përballur me akumulim të konsiderueshëm të borxheve, duke vështirësuar menaxhimin e qëndrueshëm financiar dhe duke rrezikuar

vazhdimësinë e shërbimeve në disa periudha të vitit kjo për shkak të mungesës së Kesh Flow-it për të kryer obligimet dhe qarkullimet e nevojshme financiare.

Përkundër këtyre sfidave, gjatë vitit 2025 kemi vazhduar të ofrojmë shërbime për qytetarët e Komunës së Lipjanit, dhe komunave të tjera ku operojmë. Angazhimi ynë ka qenë i fokusuar veçanërisht në përmirësimin e menaxhimit dhe grumbullimit të mbeturinave, si funksion primar i ndërmarrjes.

Gjatë këtij viti kemi realizuar projekte të rëndësishme në bashkëpunim me institucionet lokale, si dhe kemi forcuar kapacitetet tona për reagim ndaj nevojave emergjente, falë bashkëpunimit me ndërmarrje të tjera publike, veçanërisht me Ndërmarrjen Publike Banesore dhe Gjellbër Sh.A. si dhe kompanitë tjera regjionale publike që ofrojnë shërbimin e grumbullimit të mbeturinave. Falë këtyre bashkëpunimeve ne edhe në Njësinë e Lipjanit bazuar në marrëveshjes me Komunën e Lipjanit kemi përpiluar Projekt planin për krijimin e bazës për pikën e transferit, si dhe matjet e kostove për rregullimin e objektit të rinj përfshirë edhe rrethojat, kjo e mundësuar përmes bashkëpunimit mes NPB Banesore, ku edhe kemi investuar ne si kompani në ndërtimin e struktures se betonit në këtë pike transferi.

Megjithatë, pas një angazhimi të vazhdueshëm institucional dhe ligjor, kemi arritur që vitin financiar 2025 ta mbyllim me bilancë pozitiv për një vlerë mbi 4.8 milion euro bazuar në pasqyrat financiare për vitin 2025 të KRM Pastrimi. Një zhvillim i rëndësishëm është arritur në javën e dytë të muajit dhjetor 2025, në aspektin financiar përmes përmbarimit, ndërmarrja ka arritur të arkëtojë gjithsej 2,701,953.32 €, si rezultat i përkushtimit të menaxhmentit dhe angazhimit për zgjidhje institucionale përmes marrëveshjes së ndërmjetësimit si dhe vendimit të Gjykatës Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë për shumën prej 844,461.24 €, dëm financiar i cili ishte shkaktuar për periudhën maj-dhjetor 2024. Ky moment ka shënuar një kthesë të rëndësishme në stabilizimin fillestar financiar të ndërmarrjes, duke rritur rrjedhjen e parasë (Kesh Flow-in), si një mundësi reale që gjatë vitit 2026 të rrisim kapacitetet të makinerisë qoftë me mirëmbajtje më efikase, qoftë edhe me blerje të pajisjeve të reja.

Gjatë kësaj periudhe, në funksion të menaxhimit dhe mbarëvajtjes së ndërmarrjes, janë nxjerrë 612 vendime të natyrave të ndryshme, janë trajtuar 111 kërkesa dhe janë dhënë 105 përgjigje zyrtare. Njëkohësisht, janë zhvilluar takime të rregullta me përfaqësues të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, përfshirë KfW, kryetarë komunash dhe drejtorë të shërbimeve publike, si dhe është raportuar në mënyrë të vazhdueshme para Bordit të Drejtorëve.

Pavarësisht vështirësive, mbetemi të përkushtuar ndaj misionit tonë për ofrimin e shërbimeve cilësore dhe ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm të menaxhimit të mbeturinave. Vizioni ynë mbetet i pandryshuar: një qytet funksional, i pastër dhe me shërbime që i përgjigjen nevojave të qytetarëve çdo here në bashkëpunim të vazhdueshëm me të gjithë akterët të Komunës

2. ANALIZA FINANCIARE

2.1.GJENDJA E PËRGJITHSHME FINANCIARE E KRM “PASTRIMI” SH.A.

KRM “Pastrimi” Sh.A. si organizim i përgjithshëm, në bazë të Raportit të Pasqyrave Financiare për vitin 2025 është përmbyllur me rritje të të hyrave ku të hyrat për këtë vit janë në vlerë prej **15,430,351.08 €** për dallim nga viti 2024 që të hyrat kanë qenë në vlerë prej 11,370,670.00€.

Bazuar në Pasqyrat Financiare për vitin 2025, viti 2025 është mbyllur me **bilanci pozitiv** prej 4,823,550.34 €. Krahasuar me vitin 2024 ku bilanci ishte në vlerë 1,030,145 € rezultojnë rritje prej 3,793,405.34 € saktësisht **368.26%** €. Kjo rritje vjen si rezultat i fitimit të drejtës së faturimit nga Komuna e Prishtinës për klientet Amviseri, rritjes së emimoreve me rregullore, harmonizimi i kontratave me biznese dhe kompenzimi i demit të shkaktuar gjatë vitit 2025.

KRM PASTRIMI Sh.a			
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025			
	Shënimi	Për fund vitin 31 dhjetor 2025	Për fund vitin 31 dhjetor 2024
Të hyrat	15	12,622,707.65	10,792,577
Kostoja e shitjes	16	(2,059,805.95)	(2,143,251)
Fitimi / (humbja) bruto		10,562,901.70	8,649,325
Të ardhurat tjera	17	2,505,079.62	49,825
Shpenzimet e amortizimit	10	(445,011.37)	(629,332)
Shpenzimet e pagave	18	(7,023,353.77)	(6,896,053)
Shpenzimet administrative	19	(117,657.62)	(93,338)
Shpenzimet e mirëmbajtjes	20	(233,901.02)	(422,927)
Shpenzimet e tjera	21	(213,219.39)	(58,710)
Fitimi / (humbja) operativ		5,034,838.16	598,791
Shpenzimet financiare	22	(513,851.63)	(96,915)
Të ardhurat financiare	17.a	43,907.81	75,038
te hyrat nga grantet dhe subvencione	17	258,656.00	453,231
Fitimi / (humbja) para tatimit		4,823,550.34	1,030,145
Shpenzimet e tatimit në fitim		-	-
Fitimi / (humbja) i/e vitit		4,823,550.34	1,030,145
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:			
Diferencat këmbimore nga përkthimi i pasqyrave financiare të operacioneve të huaja, neto nga tatimi			-
Humbje nga rivlersimi I tokës			-
Gjithsej të ardhurat / (humbjet) gjithëpërfshirëse të vitit		4,823,550.34	1,030,145

Tabela krahasimore e të hyrave në 2 vitet e fundit për vitet 2025 dhe 2024:

	2025	2024
Të hyrat	15,430,351.08	11,370,670.00

Gjatë vitit 2025 është arritur të ulet numri i punëtorëve në KRM “Pastrimi” Sh.A. ku aktualisht ndërmarrja ka **825 punëtorë**, derisa në vitin 2023 numri i të punësuarve ka qenë rreth **878**

punonjës, si dhe 28 sezonal. Viti 2025 ka qenë vit i reformimit të administratës e cila ka përfshirë ndryshimet e të gjitha rregulloreve ekzistuese, ngritja profesionale të stafit, minimizimi i kostove financiare, e në veçanti përfshi edhe uljen e numrit të punonjësve si një nga parakushtet thelbësore për të stabilizuar edhe më shumë aspektin financiar në ndërmarrje. Ku krahas uljes së numrit të punëtorëve në administratë është rritur numri i nevojshëm në operativ si njësi bazë për funksionalizimin e kompanisë.

Sfidat më të mëdha për KRM “Pastrimi” vazhdonë të mbes borxhi i akumuluar në vitet paraprake ndaj Kompanisë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës (KMDK) i cili aktualisht është reth 1.1 milion €, borgj i cili aktualisht rrezikon seriozisht në ndalimin e qasjes për zbrazjen e mbeturinave sipas njoftimit zyrtarë të marrë nga ta për të kryer të gjithë obligimin e borxheve të trashëguar në vitet paraprake, sepse të gjitha obligimet e tanishme të krijuara nga janari 2026 e tutje jemi duke i kryer me kohë dhe një pjesë duke paguar për borgjin e akumuluar sipas mundësive financiare (ku nga 2.2 milion sa ka qenë borgji në dhjetor të vitit 2025 tani e kemi rreth 1.1 milion euro. Rreth sfidave duhet të parashihet një mbështetje nga të gjithë aksionarët ligjor në mënyrë që të kalohet sfida dhe të kemi përmirësim të kushteve dhe cilësisë së shërbimit për qytetarët.

3. GJENDJA FINANCIARE NË NJËSINË OPERATIVE NË LIPJAN

3.1.TË ARDHURAT NË NJËSINË E LIPJANIT

Totali i të ardhurave të inkasuara për vitin 2025 ka arritur në 748,894.76 €, të ndara në këto kategori kryesore. Të inkasuara nga:

- Amvisëritë (483,912.79 €).
- Bizneset (61,778.31 €).
- Institucionet (1,831.91 €).
- Kontrata të jashtzakonshme (201,371.75 €).
- Subvencione dhe fonde të tjera (00.00 €).

Totali i faturimit për vitin 2025, është **820,948.51 €** që i bie që me një mbetje të pa inkasuar prej 72,053.75 €. Pjesa e mbetur e pa inkasuar është në pjesën më të madhe nga sektori i amvisërisë (51,572.31 €) e cila ka ardhë si rrjedhojë e ndikimit të disa faktorëve përfshirë këtu që një pjesë e konsiderueshme janë nga lista e rasteve sociale të cilët në vitet paraprake janë subvencionuar nga Komuna, për dallim që në vitin 2025 nuk është bërë një gjë e tillë. Megjithatë të gjitha borgjet e painkasuara do të dërgohen në procedurën përmbarimore si mjete i vetëm ligjor për të arritur inkasimin e nevojshëm.

3.2.SHPENZIMET

Totali i shpenzimeve dhe obligimeve në paga dhe shpenzimeve tjera të faturuara për vitin 2025 ka arritur në 876,357.20 €, të cilat janë të ndara në:

- Pagat, kontributet si dhe pagesat tjera për punonjësit (485,333.59 €)
- Shpenzimet operative: Kosto për mirëmbajtjen e infrastrukturës, furnizime, Tatime dhe detyrime ndaj institucioneve shtetërore si dhe shërbime të jashtme (391,023.61 €)

3.3.BILANCI FINANCIAR

Njësia Operative Lipjan ka mbyllur vitin financiar 2025 me bilancë negativ me një minus prej (-55,408.69 €), e cila kryesisht ka ardhur si rezultat i:

- Mungesa e rritjes së tarifës për shërbimin e grumbullimit të mbeturinave për një periudhë të gjatë dhe e cila ende vazhdon me qenë e njëjtë.
- Rritjes së tarifës së Deponisë për çdo vit për vlerën një (1) €/ton mbeturine, sipas Vendimit të Qeverisë/Ministritë përkatëse dhe e cila ka një impakt të drejtpërdrejt.
- Rritja e pagave dhe shujtës për punonjësit e Njesisë Operative të Lipjanit. Duke i shtuar edhe rritjen e pagës minimale që do të jetë rritje e re edhe gjatë vitit 2026.
- Rritja e çmimeve në tregë të derivateve dhe shpenzimeve tjera operative (naft, vajra, pjesë, etj.)
- Mungesa e subvencioneve eventuale për të mbuluar shpenzimet në rritje.

4. ANALIZA FINANCIARE KRAHASUAR ME VITIN PARAPRAK DHE NDIKIMET FINANCIARE NË BILANC PËRFUNDIMTAR TË NJËSISË

Impakti kryesor në gjendjen financiare e cila ka rezultuar me përmbyllje të vitit me bilancë negativ prej -55,408.69 €, ka të bëjë direkt disa faktorë kyç, për dallim që viti paraparak 2024 që njësia ka operuar me bilanc pozitiv 26,588.64 €, edhe pse sikurse kemi raportuar edhe në vitin paraparak bilanci ka qenë pa ndarje të kostove financiare dhe me matje sipas llogaritjes së përqindjeve të aksioneve.

Faktori i parë është rritja e çmimeve të tregut të përgjithshëm për të gjitha shpenzimet operative dhe administrative të cilat janë jetike për ndërmarrjen tonë, duke filluar nga rritja e derivateve (nafta, rritja e tarifës së mbeturinave në KMDK, vajrat, pjesët rezervë, shpenzimet në intervenime të prishjeve, etj). Në rastin konkret për sa i përket shpenzimeve të Deponisë (Kompanisë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës) kemi rritje të vazhdueshme të tarifës në bazë të Vendimit të Qeverisë (Ministritë përkatëse), i cili përcakton rritje prej një (1) euro për tonë të mbeturinës, dhe rritja përcaktohet të aplikohet nga çdo1 janar i vitit.

Përshembull një tonë mbeturinë në vitin 2022 ka pasur çmimin prej 5.73 €, ndërkaq në vitin 2023 e njëjta sasi është rritur për vlerën prej 7.89 €, në vitin 2024 çmimi është rritur në 8.97, në vitin 2025 çmimi i tonit të mbeturinave është rritur në 10.05 €. Ndërkaq nga janari 2026 një tonë mbeturinë është rritur në 11.13 €.

Tabela krahasimore e shpenzimeve/çmimit të caktuar nga Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës për një tonë mbeturinë për vitin 2022, 2023, 2024, 2025 dhe 2026:

Viti	Çmimi për një tonë mbeturinë
2022	5,73 €
2023	7.89 €
2024	8.97 €
2025	10.05 €
2026	11.13 €

Bazuar në rritjen e përvjetshme të deponimit të mbeturinave në Kompaninë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës dhe e cila do të pritet të rritet deri në vitin 2027 sipas vendimit të Ministrisë së Ekonomisë, del që ndikimi i rritjes ka pasur efekt të drejtëpërdrejt për të krijuar edhe bilancin negativ të operimit financiar në njësi. Kjo për faktin se fatura e tarifës së deponimit të mbeturinave ka mesatarisht e ngritje totale vjetore prej rreth 10%.

Tabela krahasimore e shpenzimeve/çmimit të shpenzimeve në deponi për vitin 2023, 2024 dhe 2025:

Viti	Shpenzimet në KMDK	
	PAGUAR	OBLIGIMET E FATURUARA
2023	88,888.60 €	104,769.60 €
2024	65,326.15 €	123,421.42 €
2025	37,285.85 €	138,659.86 €

Faktori i dytë ka të bëjë me rritjen e shpenzimeve të naftës, vajrave dhe shpenzimeve tjera operative (shpenzimet operative dhe administrative) dhe të cilat janë jetike për ndërmarrjen tonë. Në vështrim krahasimor të vlerës së këtyre shpenzimeve na del se shpenzimet e vitit raportues 2025 janë **391,023.61 €** duke pasur një rritje të kostove operative për dallim me vitin paraprak 2024 ku shpenzimet operative përfshirë edhe shpenzimet në deponi kanë qenë 232,484.76 €. Me këtë është e qartë që kostoja e rritjes së çmimeve në treg ka ndikuar drejtpërsëdrejti në bilacin financiar dhe në pamundësitë reale për të pasur një bilancë pozitiv financiar.

Tabela krahasimore e shpenzimeve/çmimit të shpenzimeve operative për vitin 2023, 2024 dhe 2025:

Viti	Shpenzimet operative dhe administrative
2023	257,659.27 €
2024	232,484.76 €
2025	391,023.61 €

Faktori i tretë ka të bëjë me lartësinë e tarifës për shërbimin e grumbullimit të mbeturinave e cila ende qëndron e pa ndryshuar edhe përkundër rritjes në masën më të lartë të të gjitha çmimeve për produktet dhe shpenzimet tjera operative të cilat janë thelbësore për operimin e ndërmarrjes. Çmimi i tarifës vazhdon të jenë në vlerë prej 4.7 € i cili është i pandryshuar për

shumë vite, madje kjo tarifë në rast se largojmë edhe TVSH si vlerë e shtuar, ne si ndërmarrje koston e pagesës neto e kemi rreth 3.85 €, vlerë e cila është e pamundur të mbuloj shpenzimet operative të nevojshme e as për së afërmi të na jep mundësitë reale për të bërë investime kapitale me makineri të reja. Në bazë të matjeve dhe analizave të tregut dhe aseteve dhe shpenzimeve operative të ndërmarrjes është ardhur në përfundim që minimalisht tarifa të jetë neto 6.20 €, kjo bazuar në matjet profesionale të bërë nga konsulenca e jashtme. Aktualisht, njësitë operative (qytetet aksionare) që kanë rritur tarifën sipas vlerës së propozuar, janë Prishtina, Fushë Kosova dhe Obiliqi për vlerën 6.20 €. Rritja apo harmonizimi i tarifës në të gjitha njësitë është edhe një parakusht për implementimin e projektit të financuar nga KFW-ja dhe BE për KRM “Pastrimi” për një vlerë totale implementuese rreth 74 milion €, projekt nga i cili përfiton drejtpërdrejtë edhe Komuna e Lipjanit.

5. REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM

Duke marrë parasysh gjendjen financiare, rekomandojmë masat e mëposhtme për të rritur qëndrueshmërinë financiare të njësisë:

1. Rishikimi i tarifave për shërbimet e ofruara – Aktualisht, Komuna e Lipjanit nuk ka një tarifë të harmonizuar me tarifën e komunave që kanë bërë rritje përfshirë edhe aksionarin kryesor. Tarifa ekzistuese nuk ka pësuar rritje prej vitesh pavarësisht që rritjet në treg përfshirë edhe rritjen enorme të tarifës së deponisë. Vendosja e një strukture tarifore unike në të gjitha njësitë e që do të pasqyrojë kostot reale të operimit do të ndihmonte në mbulimin e shpenzimeve dhe stabilizimin e financave, e gjithashtu edhe mundësitë financiare për të investuar në makineri të reja.
2. Bashkëfinancim për blerje të kamionëve të rinj me qëllim që të arrihet përmirësimi i cilësisë së shërbimit.
3. Strategji të reja për rritjen e të ardhurave – Përmirësimi i inkasimit nga shërbimet dhe identifikimi i burimeve të reja të financimit. Përfshirë kontrata në shtëpi për shërbime të cilat mund të i ofrojmë ne si ndërmarrje.
4. Optimizimi i shpenzimeve të personelit – Rishikimi i strukturës së pagave dhe reduktimi i shpenzimeve joproduktive në rast se vazhdohet me gjendje të rënduar financiare të njësisë.
5. Mbështetje financiare nga Komuna e Lipjanit – Rritja e subvencioneve për të mbuluar deficitin financiar dhe për të garantuar operacione të qëndrueshme. Përfshirë këtu edhe vazhdimin e subvencionimit për borgjet e krijuara nga kategoritë e rasteve sociale.

6. KONKLUZION

Njësia Operative Lipjan është përballur me sfida të rëndësishme financiare gjatë vitit 2025. Për shkak të intervenimeve në vazhdimësi të rregullimit të mjeteve ekzistuese dhe atyre që për një periudhë të gjatë kanë qenë jashtë përdorimit, përfshirë në veçanti edhe aksidentet në makineri të veçanta e të cilat janë të rëndësishme së lartë për njësinë. Bilanci ekzistues prej -80,532.10€ tregon nevojën urgjente për ndërhyrje strategjike, si fillim në rritjen e tarifës dhe tutje duke bërë optimizimin e shpenzimeve operative aty ku është e mundur dhe e përshtatshme si dhe mbështetje eventuale nga Komuna e Lipjanit.

7. VIZIONI PËR TË ARDHMEN E KOMPANISË

Si ndërmarrje në përgjithësi, përfshirë Njësine Operative të Lipjanit në veçanti, do të vazhdojmë të zhvillohemi dhe të shndërrohemi në liderë të qëndrueshëm dhe inovativë, duke ofruar shërbime me cilësi të lartë dhe duke përmbushur nevojat e klientëve dhe komunitetit, derisa në të njëjtën kohë të arrijmë të optimizojmë kostot financiare duke rritur efikasitetin operativ. Për të arritur në një shkallë të tillë duhet të ketë një ndërlidhje të vazhdueshme në mes Komunës dhe ndërmarrjes dhe sigurisht duke punuar shumë në drejtim të finalizimit të projektit mbështetës financiar nga KfW dhe Bashkimi Evropian si një projekt që ofron zgjidhje të qëndrueshme dhe afat gjate.

Pjesë e vizionit është edhe finalizimi dhe zbatimi i **DECENTRALIZIMIT TË KOSTOVE FINANCIARE**. Në organizimin e përgjithshëm të ndërmarrjes është filluar procesi i decentralizimit (ndarjeve) të kostove financiare të gjashtë (6) njësive të KRM “Pastrimi” Sh.A. Nga janari i vitit 2024 çdo faturë nga furnitorët, shpenzim operativ, shpenzime administrative, shpenzime në paga dhe çdo pagesë tjetër janë të ndara për secilën njësi veç e veç. Janë ndarë të gjitha kostot financiare të cilat evidentohen dhe faturohen për njësi, pra faturat që tani i pranojmë (*psh. Faturat e shpenzimeve të Deponisë, Vajrave, Naftës, si dhe çdo shpenzim apo blerje*) janë të ndara për secilën njësi në emërtim të njësisë përkatëse, si në këtë rast për njësine e Lipjanit. Bazuar në fazën e implementimit të decentralizimit financiar, kemi caktuar edhe zyrtarët të cilët do të merren veçanërisht me kostot financiare të njësive, derisa të arrihet përgatitja e përgjegjësve financiarë në njësitë operative të jenë të gatshëm për të kryer ekzekutimin e pagesave, sepse në bazë të kësaj ndarjeje është përcaktuar edhe përgatitja e listës së pagave si dhe ekzekutimi i pagave sipas secilës njësi operative. Në kuptim të këtyre veprimeve gjithashtu kemi hapur nënlllogaritë bankare për secilën njësi operative, ku parashihet që të hyrat dhe shpenzimet e njësive të barten në ato nënlllogari bankare. Poashtu edhe planifikimi i prokurimit është bërë i veçantë për Njësine Operative të Lipjanit sipas nevojave dhe kërkesave të paraqitura nga vetë njësia.

Aktulisht mos zbatimi apo aplikimi në praktik i decentralizimit financiar është fakti që përbërja e aksionarëve të kompanisë ka qenë jo funksionale dhe pa vendimarrje. Kjo për arsye se aksionari kryesor vendimarrës Komuna e Prishtinës që nga janari i vitit 2024 nuk e ka pasur të funksionalizuar Komisionin e Aksionarëve duke pamundësuar vendimarrje, e cila do të mundësonte ndryshim plotësimin e Statutit të kompanisë si bazë për zbatim të decentralizimit financiar real, në veçanti mënyrën e ekzekutimit të pagave të secilës njësi bazuar në buxhetin e tyre real e sidomos edhe rregullimin ligjor të përgjegjësive të aksionarëve në rastet kur njësitë të caktuara operojnë me bilancë negativ, bilancë i cili duhet të mbulohet nga aksionarët përgjegjës në çdo situatë kur shkakua pasoja e bilancit nuk është si përgjegjësi e ndërmarrjes por e faktorëve që ndikojnë nga aksionarët.

7.1. Qëllimet Strategjike për të Ardhmen

1. **Rritja e Qëndrueshmërisë Financiare dhe Operative.** Kompania synon të konsolidojë pozitën e saj financiare përmes përmirësimit të menaxhimit të shpenzimeve, rritjes së efikasitetit të proceseve dhe optimizimit të përdorimit të

burimeve. Rritja e transparencës dhe implementimi i një sistemi të avancuar për menaxhimin e financave do të mundësojnë që kompania të ruajë një qëndrueshmëri të qëndrueshme, ndërkohë që i shërben më mirë klientëve të saj.

2. **Rajtja dhe impementimi i Projektit të mbështetur nga KfW dhe BE.** Projekti në fjalë parashih investime serioze kapitale në infrastrukturën e makinerisë dhe objekteve ekzistuese përmes të cilave do të bëhet ndarja dhe selektimi i mbeturinave që në burim dhe deri në fazën finale të trajtimit (leter, plastik, xham, kompostim, etj). Përmes këtij projekti parashihen blerja e mbi 100 kamionëve dhe pajisjeve tjera të veçanta për mbledhjen e mbeturinave ku do të mundësohet edhe riciklimi si një proces i së ardhmës sipas praktikave më të mira të shteteve evropiane. Projekti në total parashih vlerën investive prej 74 milionë euro, derisa nga shtatori i vitit 2024 veç se janë zotuar mjetet prej 24.1 milionë euro si fazë e parë e cila parashih blerjen e mbi 100 kamionëve dhe pajisjeve tjera si dhe blerjen e mbi 10,000.00 kontejnerë të parapara për ndarjen dhe seleksionimin e llojeve të mbeturinave.
3. **Transformimi digital dhe teknologjik.**Njëësia Operative në Lipjan do të përfitojë nga investimet e planifikuara në teknologji dhe automatizim për të përmirësuar planet operative dhe për të siguruar që të mund të përballojë sfidat e të ardhmes në operimin e përditshëm. Përdorimi i sistemeve digjitale për monitorimin e proceseve, planifikimin dhe optimizimin e transportit të mbeturinave do të çojë në uljen e kostove dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve. Teknologjitë e reja do të mundësojnë edhe përmirësimin e procesit të grumbullimit të mbeturinave dhe reduktimin e ndikimeve mjedisore.
4. **Përmirësimi i cilësisë së shërbimit dhe përmbushja e standardeve të larta.** Kompania synon të vazhdojë të ofrojë shërbime të shpejta dhe efikase, me një përqendrim të veçantë në përmbushjen e standardeve të cilësisë dhe përmirësimin e zbatimit të planit operativ. Kjo përfshin rritjen e kapaciteteve të ekipit dhe trajnimin e vazhdueshëm të stafit për të siguruar një shërbim të nivelit të lartë, si dhe zhvillimin e mëtejshëm të partneriteteve me komunitetin dhe bizneset për të garantuar një bashkëpunim të suksesshëm.
5. **Inovacioni dhe përdorimi i burimeve të gjelbërta dhe të qëndrueshme.** Kompania do të adoptojë praktika më të qëndrueshme dhe të gjelbërta, duke kontribuar në ruajtjen e mjedisit dhe duke rritur përdorimin e burimeve rinovueshme dhe teknologjive të pastra. Përdorimi i burimeve të rinovueshme për energji dhe optimizimi i proceseve për të ulur ndikimin mjedisor do të bëhen pjesë integrale e strategjisë së kompanisë. Një shembull konkret është zbatimi i projektit i cili është në proces e sipër i mbështetur nga KfW dhe BE.
6. **Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe angazhimi me punonjësit.** Kompania do të investojë në zhvillimin dhe trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve për t'u siguruar që ata të jenë të përgatitur për sfidat dhe mundësitë që do të vijnë. Rritja e motivimit dhe angazhimi i punonjësve do të jenë të rëndësishme për të siguruar një performancë të lartë dhe për të mbajtur një mjedis pune të shëndetshëm dhe produktiv si për kompaninë ashtu edhe për komunitetin.
7. **Rritja e konkurrencës dhe ekspansioni i tregut.** Kompania do të vazhdojë të rrisë konkurrencën dhe të përmirësojë shërbimet për klientët, duke u angazhuar për zhvillimin e mundësive të reja dhe zgjerimin e llojeve të shërbimeve. Kjo mund të përfshijë një shtrirje të mundshme në tregje të reja ose të rritjes së aktivitetit me klientët ekzistues, duke ofruar shërbime më të përparura dhe më të personalizuar.
8. **Përmirësimi i partneriteteve dhe bashkëpunimeve me komunitetin.** Kompania do të vazhdojë të ndërtojë marrëdhënie të forta me autoritetet lokale (Komunat), komunitetet dhe bizneset, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetesës për

qytetarët dhe duke u angazhuar në aktivitete që promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit.

7.2.Përfundimi:

Në të ardhmen, **Njësia Operative në Lipjan** synohet që të jetë më moderne, më efikase dhe më e angazhuar ndaj komunitetit dhe mjedisit. Përmes përmirësimit të vazhdueshëm të planit operativ dhe implementimit të teknologjive të reja, do të mundësohet një rritje e qëndrueshme dhe një përmirësim i shërbimeve për klientët, duke e bërë atë një udhëheqës të vërtetë në industrinë e menaxhimit të mbeturinave, duke synuar që të bashkohemi me sistemet më të sofistikuar të shteteve të zhvilluara duke pasur për synim kryesor fillimin e ndarjes së llojeve të mbeturinave në burim e deri në avancimin e strategjisë dhe punës në reciklim si një zgjidhje afatgjate dhe jetësore që ka të vetmin qëllim, mbrojtjen e ambientit dhe shëndetit publik.


Bashkëngjitur me Raportin, gjeni:

- *Raportin e detajuar financiar në formë tabelare të Njesisë Operative të Lipjanit për vitin 2025;*
- *Pasqyrat Financiare për vitin 2025;*

Prishtinë, 25.03.2026

Petrit Reçica

Kryeshf Ekzekutiv



Kompania Rajonale e Mbeturimave
Regionale e Pastrimit dhe Uklësimit të Otpada
"PASTRIMI" SH.A./d.d.

Nr. 05102/15 Shtojcë
Dt. 11.02.2026



Kompania Rajonale e Mbeturimave "Pastrimi" SH.A.

PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN 2025

Shkur 2026

Kompania Rajonale e Mbeturinave "Pastrimi" Sh.A - Prishtinë është ndërmarrje publike regjionale e cila operon në cilësinë e një shoqërie aksionare e themeluar sipas Ligjit 03/L-087 mbi Ndërmarrjet Publike, Ligjit Nr 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare dhe legjislacioneve tjera përkatëse. Ndër të tjerash KRM "Pastrimi" Sh.A është ndërmarrje e specializuar me një përvojë pune me më shumë se 60 vite në ofrimin e shërbimeve me rëndësi të veçantë shoqëro-ekonomike për qytetarët, duke kujdesur për bartjen e mbeturinave dhe mirëmbajtjen e pastërtisë dhe higjienës publike.

Ligji për Ndërmarrjet Publike ka përcaktuar që KRM "Pastrimi" Sh.A ka të përcaktuar komunat si aksionar, duke respektuar detyrimet dhe të drejtat e tyre në përputhje me ligjin. Aksionarët e kompanisë janë gjashtë (6) komuna, si: Prishtina, Podujeva, Lipjani, Fushë Kosova, Drenasi dhe Obiliqi.

Kompania Rajonale e Mbeturinave "Pastrimi" SH.A. është e regjistruar në Agjensionin e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë me numër Unik Identifikues 811276957. Aktivitetet kryesore të kompanisë janë shërbimet e grumbullimit, largimi dhe trajtimi i mbeturinave, veprimtaritë e ngjajshme sanitare, mbledhja e mbeturinave, pastrimi dhe larja e rrugeve.

1. BAZAT E PËRGATITJES DHE PAJTUESHMËRISË

a) Deklarata e përputhshmërisë së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare të bashkëngjitura me këtë raport janë të pergaditura në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

b) Bazat e matjes

Pasqyrat Financiare të paraqitura në këtë raport janë përgatitur duke u bazuar në koston historike

c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat Financiare janë të paraqitura në monedhën Euro, monedhë e cila është funksionale për shoqërinë.

d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që të bëhet mbi bazën e gjykimeve, çmuarjes dhe supozimeve të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të pasurive, detyrimeve, ardhurave dhe shpenzimeve .

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet edhe në periudhat e ardhme që ndikohen.

2. ADOPTIMI I STANDARDEVE TË REJA DHE TË RISHIKUARA NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR

Zbatimi i standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar SNRF të reja dhe të ndryshuara

Ndryshimet në SNRF janë të obligueshme dhe efektive për vitin aktual.

Ndryshimet e SNRF të ndodhura me 01.01.2023 janë:

SNRF 17 Kontratat e Sigurimit

Ndryshimet në SNK 1: Prezantimi i Pasqyrave Financiare: Klasifikimi i Detyrimeve si Afatshkurta ose Afatgjata

Shpалosja e Politikave të Kontabilitetit: Ndryshimet në SNK 1 Prezantimi i Pasqyrave Financiare dhe Deklarata e Praktikës së SNRF-ve

Ndryshimet në SNK 8 Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet në Vlerësimet e Kontabilitetit dhe Gabimet: Përkufizimi i Vlerësimeve të Kontabilitetit

Ndryshimet në SNK 12 Tatimi i shtyrë në lidhje me pasuritë dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTBËL

a) Kapitali themelues

Shoqëria ka të regjistruar kapital themelues 25,000.00 Euro.

b) Njohja e të ardhurave

Të ardhurat përfshijnë vlerën e drejtë të shumës së marrë ose që është për tu marrë nga të gjitha

shitjet e shërbimeve apo mallrave gjatë aktivitetit të zakonshëm të Shoqërisë. Të ardhurat paraqiten neto nga tatimi mbi vlerën e shtuar kthimet dhe uljet. Të ardhurat njihen kur rrisqet dhe përfitimet kryesore lidhur me pronësinë e mallrave janë transferuar tek blerësi, shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme, kostot që kanë ndodhur sot ose që do të ndodhin lidhur me transaksionin mund të maten në mënyrë të besueshme.

c) Përfitimet e punonjësve

Kontributet Pensionale. Çdo punëdhënës është i detyruar që të kontribuojë në emër të punonjësve të vetë në fondin e kontributeve pensionale në vlerën prej 5 % të pagës bruto. Gjithashtu punonjësit detyrohen që të kontribuojnë në vlerën 5 % të pagës bruto.

d) Shpenzimet

Shpenzimet operative njihen në momentin kur ato ndodhin.

e) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi prej llogarive në banka dhe fitimet neto nga kursi i këmbimit që njihen në fitim ose humbje. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit, komisionet bankare dhe humbjet neto nga kursi i këmbimit që njihen në fitim ose humbje.

f) Tatimi në fitim

Tatimi në fitim ose humbja e vitit përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në fitim ose humbje përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normen tatimore në fuqi ose që hyn në fuqi në datën e raportimit.

Tatimi i shtyrë është llogaritur duke përdorur metoden e detyrimit në bilanc, nga diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të pasurive dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe bazës tatimore. Shuma e tatimit të shtyrë është llogaritur bazuar në metoden e realizimit të kompensimit të vlerave kontabël të pasurive dhe detyrimeve duke përdorur shkallë tatimore që janë në fuqi menjëherë në datën e raportimit.

6 Paraja dhe ekuivalentet e saj	Me 31 Dhjetor 2025	Me 31 Dhjetor 2024
Paraja ne banke	1,691,873.51	22,035
Paraja ne arke	1,254.03	906
Xhirime të brendëshme	11.03	5
Gjithsej:	1,693,138.57	22,946

Paraja në arkë përfshin: Arkën qendrore Prishtinë, Podujeve, Lipjan, Drenas, Fushë Kosovë dhe Obiliq.

Paraja në bankë përfshin: Paratë në bankat Banka Ekonomike, Banka Kombëtare Tregtare, BANKA KREDITORE, Banka per Biznes, NLB Prishtina, Pro Credit Bank, Raiffaisen Bank, TEB SLLA.

7 Llogarite e arketueshme tregtare dhe te tjera	Me 31 Dhjetor 2025	Me 31 Dhjetor 2024
Klienti Amvisni	18,488,493.17	13,181,897
LOKALE	5,133,021.90	4,876,381
Kontrata	2,151,688.27	2,924,755
Institucione	396,369.93	381,865
Gjithsej:	26,169,573.27	21,364,897

	Me 31 Dhjetor 2025	Me 31 Dhjetor 2024
Ll e arketueshme Bruto	26,169,573.27	21,364,897
Avanset e pranuar:	161,122.45	-
	26,330,695.72	21,364,897
Minus: lejimet	(17,576,622.97)	(17,157,772)
Ll. Neto	8,754,072.75	4,207,125
Totali I llogarive te arketueshme	8,754,072.75	4,207,125

9 Pasurite financiare sipas vleres se drejte	Me 31 Dhjetor 2025	Me 31 Dhjetor 2024
Paradhënie për punonjësit	10,376.55	5,312
Llogarit e pagushme	31,274.07	10,281
Gjithësej	41,650.62	15,593

10. Prona pajisje dhe impiante					
	Toka	Objektet Ndërtimore	Automjetet, makineri dhe pajisje	Investimet ne vijim	Total
Më 31 dhjetor 2024	2,503,000	1,734,463	4,710,277	-	8,947,740
Zhvlerësimi i akumuluar:	-	854,206	3,143,482		3,997,688
Më 1 janar 2024					
Zhvlerësimi për vitin 2024	-	86,240	536,401		622,641
Heqjet nga përdorimi					
Më 31 dhjetor 2024	-	940,446	3,679,883	-	4,620,329
Më 31 dhjetor 2024	2,503,000	794,016	1,030,394	-	4,327,411
Kosto historike	2,503,000	1,734,463	4,710,277		8,947,740
Më 1 janar 2025					
Heqjet nga përdorimi					
Shtesat gjatë vitit			293,073		293,073
Më 31 dhjetor 2025	2,503,000	1,734,463	5,003,350	-	9,240,813
Zhvlerësimi i akumuluar:		940,446	3,679,883		4,620,329
Më 1 janar 2025					
Zhvlerësimi për vitin 2025		86,427	358,585		445,011
Heqjet nga përdorimi					
Më 31 dhjetor 2025	2,503,000	1,026,873	4,038,468	-	5,065,341
Më 31 dhjetor 2025	2,503,000	707,590	964,883		4,175,472

Detyrimet

	Me 31 Dhjetor 2025	Me 31 Dhjetor 2024
11. Llogarite e pagueshme tregtare dhe te tjera		
KL.MC-Deponia/Prishtine /Podujeve	1,769,939.25	1,103,067
Furnitoret lokal	533,383.23	1,148,230
Të pagueshmet tjera afatshkurta	25,783.24	-
Gjithsej:	2,329,105.72	2,251,297

	Me 31 Dhjetor 2025	Me 31 Dhjetor 2024
12. Të hyrat e shtyera nga Grantet		
Grantet e fituara me 01 Janar	697,138	950,369
Grantet e fituara gjat vitit	29,266.00	200,000
Gjithsej:	697,138	1,150,369
Të hyrat e njohura	(229,390.00)	(453,231)
Gjithsej:	467,748.19	697,138

	Me 31 Dhjetor 2025	Me 31 Dhjetor 2024
13 .Të pagueshme tatimore		
Tatimi i pagushëm në të ardhura personale	62,495.78	53,061
Kontributet pensionale të pagueshme	35,252.64	109,275
TVSH e pagueshme	48,825.53	90,203
Tatimi mbi Qeran		
Tatime tjera	1,379,305.43	
Gjithsej:	1,525,879.38	252,539

	Me 31 Dhjetor 2025	Me 31 Dhjetor 2024
14. Detyrimet tjera afatshkurta		
Detyrimet tjera	8,182.00	8,182.00
Sindikata	11,289.78	1,975.97
Provizione dhe taksa tjera		-
Pagat e Pagushme	23,199.82	42,264
Parapagime te arketuara	6,017.12	-
Gjithsej:	48,688.72	52,422

TE HYRAT

15. Të hyrat Operative	Për fund vitin 31 dhjetor 2025	Për fund vitin 31 dhjetor 2024
Të hyrat nga amviserite	8,882,760.66	2,483,170
Të hyrat nga institucionet	58,433.03	66,327
Të hyrat nga kontratat	2,378,131.83	7,068,406
Të hyrat nga Lokale	1,303,382.14	1,174,673
Inkasim I borqeve të vjetra		
Gjithsej:	12,622,707.65	10,792,577

16. Kosto e shitjes	Për fund vitin 31 dhjetor 2025	Për fund vitin 31 dhjetor 2024
Shpenzimet e Deponis	(1,195,679.29)	(1,105,564.30)
Shpenzimet e Derivateve	(796,407.15)	(790,658.90)
Shpenzimet e marrveshjeve (nënkontraktorëve)		(160,691)
Blerje/Shpenzime mallrash, shërbimesh	(67,719.51)	(86,337)
Shpenzimet e kripës industriale		
Gjithsej:	(2,059,805.95)	(2,143,251)

17. Të hyrat tjera dhe të hyrat nga grantet	Për fund vitin 31 dhjetor 2025	Për fund vitin 31 dhjetor 2024
Ndryshime ne inventarin e produkteve te gatshem e ne proces		1,040.00
Të hyrat nga taksat përmbarimore	25,168.43	48,785
Të hyrat tjera	2,479,911.19	1,040
Gjithsej	2,505,079.62	49,825
Të hyrat nga Grantet	258,656.00	453,231
Të hyrat nga shitja e pasurive		-
Gjithsej:	2,763,735.62	503,056

17.a Të ardhurat financiare	Për fund vitin 31 dhjetor 2025	Për fund vitin 31 dhjetor 2024
Të ardhurat financiare	43,907.81	75,038
Gjithsej:	43,907.81	75,038

SHPENZIMET

18. Shpenzimet e pagave	Për fund vitin 31 dhjetor 2025	Për fund vitin 31 dhjetor 2024
Pagat dhe shpërblimet e personelit	(6,509,006.01)	(6,425,807.75)
Kontribute dhe kuota të tjera për personelin		
Shpenzime të tjera për personelin		
Sigurimet shoqërore e shëndetësore	(514,347.76)	(470,244.87)
Gjithsej:	(7,023,353.77)	(6,896,052.62)

19. Shpenzimet administrative	Për fund vitin 31 dhjetor 2025	Për fund vitin 31 dhjetor 2024
Shpenzime postare dhe telekomunikimi PTK-së	(19,164.34)	(8,105.67)
Shpenzime transpoti		(7,569.49)
Shpenzimet e Kontollimit Teknik	(2,927.10)	(1,779.68)
Shpenzimet e reklames	(4,560.00)	(2,730.00)
Provizionet bankare	(8,408.29)	(3,026.76)
Shpenzimet e faturimit	(7,150.00)	(5,264.88)
Shpenzimet per internet		(1,210.00)
Shpenzimet e sigurimit të Automjeteve	(51,013.99)	(39,110.97)
Shpenzimet tjera administrative	(27,224.23)	(24,540.91)
Gjithsej:	(120,447.96)	(93,338.36)

20. Shpenzimet e Mirmbajtjes	Për fund vitin 31 dhjetor 2025	Për fund vitin 31 dhjetor 2024
Shpenzimet e materialit të hargjuar	(84,665.28)	(131,056.15)
Shpenzime pjeseve rezerv	(1,731.62)	(1,257.61)
Shpenzimet e mbrojtje në punë	(67,046.48)	(96,558.40)
Shpenzimet e autogomave	(10,328.56)	(58,448.05)
Shpenzimet e baterive (akumulator)	(3,222.15)	(8,057.87)
Shpenzimet e mirëmbajtjes së automjeteve	(49,958.48)	(110,600.09)
Shpenzimet e Mirmbajtjes së Programit	(16,948.45)	(16,948.45)
Gjithsej:	(233,901.02)	(422,926.63)

21. Shpenzimet tjera	Për fund vitin 31 dhjetor 2025	Për fund vitin 31 dhjetor 2024
Shpenzimet e Taksave		(974.95)
Shpenzimet e Tatimit ne Prone	(3,975.03)	(1,199.56)
Shpenzimet per tatim ne burim - Qiraja	(383.02)	
Shpenzime per pritje dhe perfaqesime	(5,127.35)	(10,958.42)
Shpenzimet e reprezentacionit	(384.85)	(4,646.02)
Gjoha dhe dëmshpërblime	(1,000.00)	(4,100.00)
Shërbimet administrative dhe gjyqësore	(176,512.32)	(14,861.59)
Shpenzimet e energjisë	(20,659.79)	(14,923.96)
Shpenzimet e Ujit	(4,954.23)	(3,572.80)
Shpenzime tjera	(222.81)	(3,472.42)
Gjithsej:	(213,219.39)	(58,710)

22. Shpenzimet financiare	Për fund vitin 31 dhjetor 2023	Për fund vitin 31 dhjetor 2024
Shpenzime për interesa	(102,363)	(12,195)
Provizionimi LI/A	(411,489)	(84,721)
Gjithsej:	(513,852)	(96,915)

Kryeshef Ekzekutiv
Petrit Rocica



Zyrtare Kryesore Financiare
Shqipe Cakolli Rraci

Kontabiliste
Lirije Gashi


KRM PASTRIMI Sh.a
Pasqyra e pozitës financiare me 31 dhjetor 2025

	Shënimi	Me 31 Dhjetor 2025	Me 31 Dhjetor 2024
PASURITË			
Pasuritë afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	6	€ 1,693,138.57	22,946
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	7	€ 8,754,072.75	4,207,125
Stoqet	8	€ 154,469.02	245,567
Pasuritë financiare sipas vlerës së drejtë	9	€ 41,650.62	15,593
Pasuritë e tjera afatshkurtra	9.a	€ -	7,494
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		€ 10,643,330.96	4,498,724
Pasuritë afatgjata			
Prona, pajisjet dhe impiantet	10	€ 4,175,472.13	4,327,411
Pasuritë e paprekshme	10.a	€ 67,194.92	67,195
Pasuritë e shtyra tatimore			
Pasuritë e tjera afatgjata			
Gjithsej pasuritë afatgjata		€ 4,242,667.05	4,394,605
Gjithsej pasuritë		€ 14,885,998.01	8,893,330
DETYRIMET DHE EKUITETI			
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	11	€ 2,329,105.72	2,251,297
Të hyrat e shtyra / avanset		€ 161,122.45	110,030
Tatimet e pagushme aktuale		€ -	
Të hyrat e shtyra	12	€ 467,748.19	697,138
Tatimin në fitim i pagueshëm	13	€ 1,525,879.38	252,539
Detyrimet e tjera afatshkurtra	14	€ 48,688.72	52,422
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		€ 4,532,544.46	3,363,427
Detyrimet afatgjata			
Përfitimet e punonjësive të pagushme			
Detyrimet e tjera afatgjata			
Gjithsej detyrimet afatgjata			-
Gjithsej detyrimet		€ 4,532,544.46	3,363,427
EKUITETI			
Kapitali aksionar		€ 25,000.00	25,000
Fitimet e mbajtura		€ 10,328,453.56	5,420,752
Rezervat e Rivlersimit			84,151
Gjithsej ekuiteti		€ 10,353,453.56	5,529,903
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		€ 14,885,998.02	8,893,330

Kryeshef Ekzekutiv
Petrit Reçica

Zyrtare Kryesore Financiare
Shqipe Cakolli Braci

Kontabilliste
Lirije Gashi



KRM PASTRIMI Sh.a			
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024			
	Shënimi	Për fund vitin 31 dhjetor 2025	Për fund vitin 31 dhjetor 2024
Të hyrat	15	€ 12,622,707.65	10,792,577
Kostoja e shitjes	16	€ (2,059,805.95)	(2,143,251)
Fitimi / (humbja) bruto		€ 10,562,901.70	8,649,325
Të ardhurat tjera	17	€ 2,505,079.62	49,825
Shpenzimet e amortizimit	10	€ (445,011.37)	(629,332)
Shpenzimet e Pagave	18	€ (7,023,353.77)	(6,896,053)
Shpenzimet administrative	19	€ (117,657.62)	(93,338)
Shpenzimet e mirëmbajtjes	20	€ (233,901.02)	(422,927)
Shpenzimet e tjera	21	€ (213,219.39)	(58,710)
Fitimi / (humbja) operativ		€ 5,034,838.16	598,791
Shpenzimet financiare	22	€ (513,851.63)	(96,915)
Të ardhurat financiare	17.a	€ 43,907.81	75,038
te hyrat nga grantet dhe subvencione	17	€ 258,656.00	453,231
Fitimi / (humbja) para tatimit		€ 4,823,550.34	1,030,145
Shpenzimet e tatimit në fitim		-	-
Fitimi / (humbja) i/e vitit		€ 4,823,550.34	1,030,145
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:			
Diferencat këmbimore nga përkthimi i pasqyrave financiare te operacioneve të huaja, neto nga tatimi			-
Humbje nga rivlersimi i tokës			-
Gjithsej të ardhurat / (humbjet) gjithëpërfshirëse të vitit		€ 4,823,550.34	1,030,145

Kryeshef Ekzekutiv
Petrit Recica

Zyrtare Kryesore Financiare
Shqipe Cakolli Rraçi

Kontabiliste
Lirije Gashi



Pasqyrat Financiare për vitin 2024

KRM PASTRIMI Sh.a				
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025				
	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Rezervat e tjera	Gjithsej
	€	€	€	€
Gjendja më 31 dhjetor 2023	25,000	4,279,229	212,816	4,517,045
Fitimi / (humbja) i/e vitit		1,030,145		1,030,145
Diferencat nga korigjimet valutore		(17,286)		(17,286)
Dividendat				
Rezervat e Rivlersimit		128,665	(128,665)	-
Ndarja e rezervave				
Gjendja më 31 dhjetor 2024	25,000	5,420,752	84,151	5,529,903
Fitimi / (humbja) i/e vitit		4,823,550		4,823,550
Diferencat nga korigjimet valutore				
Dividendat				
Rezervat e Rivlersimit		84,151	(84,151)	
Ndarja e rezervave				
Gjendja më 31 dhjetor 2025	25,000	10,328,454	-	10,353,454

Kryeshef Ekzekutiv

Petrit Recica



Zyrtare Kryesore Financiare

Shqipe Cakolli Rraci

Kontabiliste

Lirije Gashi

Pasqyra e rrjedhjes së parasë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025			
	Shenime	Për fund vitin 31 dhjetor 2025	Për fund vitin 31 dhjetor 2024
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi / (humbja) i / e vitit		4,823,550.34	1,030,145
<i>Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave</i>			
Zhylerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve		445,011.37	622,641
Dëmtimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve			
Amortizimi i pasurive të paprekshme			6,690
Ndryshimi i vlerës së pronës investuese			
Të ardhurat financiare		(302,563.81)	-
Shpenzimet financiare		411,488.66	84,721
(Fitimi) / humbja nga shitja e pronës, fabrikës dhe pajisjeve			-
Shpenzimet e tatimit në fitim			-
		5,377,486.56	1,744,197
<i>Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative</i>			
(Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera		(4,958,436.53)	(2,042,598)
(Rritja) / zvogëlimi në stoke		91,097.91	(88,827)
(Rritja) / zvogëlimi në pasuritë e tjera		(18,563.64)	6,006
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera		77,808.95	353,742
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet e tjera		1,364,606.93	44,240
		1,934,000.18	16,760
Tatimi në fitim i paguar		-	(124,040)
Interesi i paguar			-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative		1,934,000.18	(107,279)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve		(293,072.97)	(93,254)
Arkëtimet për shitjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve			
Pagesat për blerjet e pasurive të paprekshme			
Arkëtimet për shiljen e pasurive të paprekshme			
Interesi i arkëtuar			
Dividendat e arkëtuara			
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet Investuese		(293,072.97)	(93,254)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Deponimet e kapitalit shtesë			-
Dividendat e paguara			-
Arkëtimet nga Kredite dhe huave			-
Pagesat e lizingut financiar		29,266.00	-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese		29,266.00	-
Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë		1,670,193.21	(200,533)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit		22,945.37	223,478
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit		1,693,138.57	22,945

Kryeshef Ekzekutiv
Petrit Recica



Zyrtare Kryesore Financiare
Shqipe Cakolli Rraci

Kontabiliste
Lirije Gashi